

**PËR RATIFIKIMIN E KONVENTËS SË HAGËS “PËR RIVENDOSJEN
NDËRKOMBËTARE TË DETYRIMIT USHQIMOR NDAJ FËMIJËVE DHE
FORMAVE TË TJERA TË MBËSHTETJES PËR ANËTAR**

**Ratifikohet konventa e Hagës “Për rivendosjen ndërkombëtare të detyrimit
ushqimor ndaj fëmijëve dhe formave të tjera të mbështetjes për anëtarët e tjerë
të familjes”, bërë në Hagë më 23 nëntor 2007.**

LIGJ

Nr. 63/2012

**PËR RATIFIKIMIN E KONVENTËS SË HAGËS “PËR RIVENDOSJEN
NDËRKOMBËTARE TË DETYRIMIT USHQIMOR NDAJ FËMIJËVE DHE
FORMAVE TË TJERA TË MBËSHTETJES PËR ANËTARËT E TJERË TË
FAMILJES”**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e
Këshillit të Ministrave,

KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet konventa e Hagës “Për rivendosjen ndërkombëtare të detyrimit ushqimor
ndaj fëmijëve dhe formave të tjera të mbështetjes për anëtarët e tjerë të familjes”, bërë
në Hagë më 23 nëntor 2007.

Neni 2

Republika e Shqipërisë deklaron, në përputhje me nenin 2 (3), të drejtën për të
përcaktuar, njohur dhe zbatuar detyrimet për mbështetjen financiare, që lindin nga një
marrëdhënie martesore në të njëjtën masë me detyrimet që lidhen me mbështetjen e
fëmijës, sipas kapitullit II dhe III të konventës.

Neni 3

Republika e Shqipërisë deklaron, në përputhje me nenin 2 (3) të Konventës, të drejtën
për të zbatuar detyrimin ushqimor edhe për fëmijët madhorë deri në moshën njëzet e
pesë vjeç, me kusht që ata të ndjekin shkollën e mesme ose të lartë, sipas nenit 197 të
Kodit të Familjes.

Neni 4

Republika e Shqipërisë deklaron, në përputhje me nenin 63 të Konventës, se kërkesat
për njohjen dhe zbatimin e një marrëveshjeje për mbështetje financiare bëhen
nëpërmjet autoritetit qendror.

Neni 5

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratur në datën 31.5.2012

Shpallur me dekretin nr. 7543, datë 15.6.2012 të Presidentit të Republikës së

Shqipërisë,

Bamir Topi

KONVENTA
PËR RIVENDOSJEN NDËRKOMBËTARE TË DETYRIMIT USHQIMOR
NDAJ FËMIJËVE DHE FORMAVE TË TJERA TË MBËSHTETJES PËR
ANËTARËT E TJERË TË FAMILJES (Lidhur më 23 nëntor 2007)

Shtetet nënshkruese të kësaj Konvente, Me dëshirën për të përmirësuar bashkëpunimin ndërmjet shteteve për rivendosjen ndërkombëtare të detyrimeve ushqimore ndaj fëmijëve dhe formave të tjera të mbështetjes për anëtarët e tjerë të familjes,

Të vetëdijshëm për nevojën për procedura që sjellin rezultate dhe që janë të arritshme, të shpejta, efektive, ekonomike, të hapura dhe të drejta, Duke dëshiruar të mbështeten në elementet më të mira të konventave ekzistuese të Hagës dhe instrumenteve të tjera ndërkombëtare, në veçanti Konventën e Kombeve të Bashkuara për rivendosjen jashtë shtetit të detyrimeve ushqimore të 20 qershorit 1956, Duke kërkuar që të përfitojnë nga përparimet në teknologji dhe të krijojnë një sistem fleksibël që mund të vazhdojë të evoluojë, ndërsa nevojat ndryshojnë dhe përparime të mëtejshme në teknologji krijojnë mundësi të reja,

Duke pasur parasysh se në përputhje me nenet 3 dhe 27 të Konventës së Kombeve të Bashkuara për të drejtat e fëmijëve të 20 nëntorit 1989,

- në të gjitha veprimet në lidhje me fëmijët, interesat më të mira të fëmijës do të kenë rëndësi parësore;
- çdo fëmijë ka të drejtën e një standardi jetese të mjaftueshëm për zhvillimin e tij fizik, mendor, shpirtëror, moral dhe social;
- prindi (prindërit) ose persona të tjerë përgjegjës për fëmijën kanë rëndësinë parësore për të siguruar, brenda mundësive dhe kapaciteteve të tyre financiare, kushtet e nevojshme të jetesës për zhvillimin e fëmijës; dhe
- shtetet palë duhet të marrin të gjitha masat e duhura, duke përfshirë nënshkrimin e marrëveshjeve ndërkombëtare, për të siguruar rivendosjen e detyrimit të mbështetjes financiare për fëmijën nga prindi (prindërit) ose persona të tjerë përgjegjës, në veçanti kur këta persona jetojnë në një shtet të ndryshëm nga ai i fëmijës; kanë vendosur të lidhin këtë Konventë dhe kanë rënë dakord për dispozitat e mëposhtme.

KAPITULLI I

OBJEKTI, FUSHA E VEPRIMIT DHE PËRKUFIZIMET

Neni 1 **Objekti**

Objekti i kësaj Konvente është garantimi i rivendosjes efektive ndërkombëtare të detyrimeve ushqimore dhe formave të tjera të mbështetjes për anëtarët e tjerë të familjes veçanërisht nëpërmjet:

- a) krijimit të një sistemi gjithëpërfshirës bashkëpunimi ndërmjet autoriteteve të shteteve kontraktuese;
- b) vënies në dispozicion të kërkesave për marrjen e vendimeve për detyrime ushqimore;
- c) parashikimit të njohjes dhe zbatimit të vendimeve për detyrime ushqimore; dhe
- d) kërkimit të masave efektive për zbatimin e shpejtë të vendimeve për detyrimin ushqimor.

Neni 2 **Fusha e veprimit**

1. Kjo Konventë zbatohet:

- a) për detyrimet ushqimore që lindin nga marrëdhënia prind-fëmijë ndaj një personi nën moshën 21 vjeç;
- b) për njohjen dhe ekzekutimin ndaj zbatimit të një vendimi për mbështetje bashkëshortore kur aplikimi është bërë me një kërkesë brenda fushës së veprimit të nënparagrafit “a”; dhe
- c) me përjashtimin e kapitujve II dhe III ndaj mbështetjes bashkëshortore.

2. Çdo shtet kontraktues, në përputhje me nenin 62, mund të rezervojë të drejtën për të parashkruar zbatimin e Konventës sipas nënparagrafit 1 “a”, për personat, të cilët nuk kanë arritur moshën 18 vjeç. Një shtet kontraktues, që bën këtë rezervë, nuk ka të drejtë të kërkojë zbatimin e Konventës për persona në moshën që përjashtohet nga rezerva e tij.

3. Çdo shtet kontraktues mund të deklarojë, në përputhje me nenin 63, se do të shtrijë zbatimin e të gjithë ose një pjese të Konventës për çdo detyrim mbi mbështetjen financiare që lind nga një marrëdhënie familjare, prindërore, martesë ose lidhjeje të afërt, duke përfshirë në veçanti detyrimet në lidhje me personat në nevojë. Çdo deklaratë e tillë sjell detyrime ndërmjet dy shteteve kontraktuese vetëm në atë masë që deklaratat e tyre mbulojnë të njëjtat detyrime të mbështetjes financiare dhe pjesë të Konventës.

4. Dispozitat e kësaj Konvente zbatohen për fëmijët pavarësisht nga gjendja civile e prindërve.

Neni 3 **Përkufizimet**

Për qëllimet e kësaj Konvente:

- a) “kreditor” nënkupton një individ, të cilit i detyrohet ose pretendohet t’i detyrohet mbështetja financiare;
- b) “debitor” nënkupton një individ, i cili ka detyrimin ose pretendohet të ketë detyrimin e mbështetjes financiare;
- c) “ndihmë ligjore” nënkupton ndihmën e nevojshme për t’i dhënë mundësinë kërkuesve të njohin dhe vërtetojnë të drejtat e tyre dhe të garantojnë që kërkesat të trajtohen në mënyrë të plotë dhe efektive në shtetin e kërkuar. Mjetet e ofrimit të kësaj ndihme mund të përfshijnë, sipas nevojës, konsulencën juridike, ndihmën në paraqitjen e çështjes para një

autoriteti, përfaqësimin ligjor dhe përjashtimin nga shpenzimet e procedimeve;

d) “marrëveshje me shkrim” nënkupton një marrëveshje të regjistruar në një mjet komunikimi, informacioni në përmbajtje të të cilës është i aksesueshëm, në mënyrë që të përdoret për referim të mëvonshëm;

e) “marrëveshje e detyrimit ushqimor” nënkupton një marrëveshje me shkrim në lidhje me pagesën e detyrimit ushqimor që:

i) është hartuar ose regjistruar zyrtarisht si instrument ligjor nga një autoritet kompetent; ose

ii) është bërë ligjërisht e vlefshme ose lidhur, regjistruar ose depozituar me një autoritet kompetent, dhe mund t’i nënshtrohet rishikimit dhe ndryshimit nga një autoritet kompetent;

f) “person në nevojë” nënkupton një person, i cili për shkak të një dëmtimi ose pamjaftueshmërie të aftësive të tij ose të saj personale, nuk është i aftë të mbështesë veten.

KAPITULLI II BASHKËPUNIMI ADMINISTRATIV

Neni 4

Caktimi i autoriteteve qendrore

1. Një shtet kontraktues cakton një autoritet qendror për të përmbushur detyrat që vendosen nga Konventa për këtë autoritet.
2. Shtetet federale, shtetet me më shumë se një sistem ligjor ose shtetet që kanë njësi autonome territoriale, janë të lira të caktojnë më shumë se një autoritet qendror, dhe të përcaktojnë shtrirjen territoriale ose personale të funksioneve të tyre. Kur një shtet ka caktuar më shumë se një autoritet qendror, ai cakton autoritetin qendror, të cilit mund t’i drejtohet çdo komunikim për transmetim autoritetit qendror përkatës brenda atij shteti.
3. Caktimi i autoritetit ose autoriteteve qendrore, informacionet e tyre të kontaktit dhe kur është e nevojshme, shtrirja e funksioneve të tyre të përcaktuara në paragrafin 2, komunikohen nga pala kontraktuese në Zyrën e Përhershme të Konferencës së Hagës për të Drejtën Private Ndërkombëtare në kohën kur instrumenti i ratifikimit ose aderimit depozitohet ose kur një deklaratë paraqitet në përputhje me nenin 61. Shtetet kontraktuese informojnë menjëherë për çdo ndryshim zyrën e përhershme.

Neni 5

Funksionet e përgjithshme të autoriteteve qendrore

Autoritetet qendrore:

- a) bashkëpunojnë me njëri-tjetrin dhe nxisin bashkëpunimin ndërmjet autoriteteve kompetente në shtetet e tyre për të arritur qëllimet e Konventës;
- b) kërkojnë zgjidhjet më të mundshme ndaj vështirësive që lindin në zbatim të Konventës.

Neni 6

Funksionet specifike të autoriteteve qendrore

1. Autoritetet qendrore ofrojnë ndihmë në lidhje me kërkesat sipas kapitullit III. Në veçanti, ata:
 - a) transmetojnë dhe marrin këto kërkesa;

- b) fillojnë ose lehtësojnë fillimin e procedimeve në lidhje me këto kërkesa.
2. Në lidhje me këto kërkesa, ata marrin të gjitha masat e duhura:
- a) kur e kërkojnë rrethanat, për të ofruar ose lehtësuar ofrimin e ndihmës ligjore;
 - b) për të ndihmuar në përcaktimin e vendndodhjes së debitorit ose kreditorit;
 - c) për të ndihmuar në marrjen e informacionit përkatës në lidhje me të ardhurat dhe, nëse është e nevojshme, rrethanat e tjera financiare të debitorit ose kreditorit, duke përfshirë përcaktimin e vendndodhjes së aseteve të tyre;
 - d) për të nxitur zgjidhje miqësore, me synim pagesën vullnetare të detyrimit ushqimor, kur është e përshtatshme me anë të përdorimit të ndërmjetësimit, pajtimit ose proceseve të ngjashme;
 - e) për të lehtësuar zbatimin në vazhdim të vendimeve të detyrimit ushqimor, duke përfshirë çdo pagesë të prapambetur;
 - f) për të lehtësuar mbledhjen dhe transferimin e përshpejtuar të pagesave të detyrimit ushqimor;
 - g) për të lehtësuar marrjen e provave dokumentuese ose provave të tjera;
 - h) për të siguruar ndihmë në përcaktimin e përgjegjësisë prindërore, kur është e nevojshme, për rivendosjen e detyrimit ushqimor;
 - i) për të filluar ose lehtësuar fillimin e procedimeve për marrjen e çdo mase të nevojshme të përkohshme, që kanë karakter territorial dhe qëllimi i të cilave është garantimi i rezultatit të një kërkesë për detyrim ushqimor ende të papërfunduar;
 - j) për të lehtësuar dërgimin e dokumenteve.
3. Funkcionet e autoritetit qendror sipas këtij neni, në masën e lejuar sipas ligjit të shtetit të tij, mund të përmbushen nga organet publike ose organe të tjera nën mbikëqyrjen e autoriteteve kompetente të atij shteti. Caktimi i këtyre organeve publike ose organeve të tjera, si dhe detajet e tyre të kontaktit dhe masa e funksioneve të tyre, i komunikohen nga një shtet kontraktues Zyrës së Përhershme të Konferencës së Hagës për të Drejtën Private Ndërkombëtare. Shtetet kontraktuese informojnë menjëherë për çdo ndryshim Zyrën e Përhershme.
4. Asgjë në këtë nen ose nenin 7 nuk interpretohet sikur vendos një detyrim ndaj një autoriteti qendror për të ushtruar kompetenca, që mund të ushtrohen vetëm nga autoritetet gjyqësore, sipas ligjeve të shtetit të kërkuar.

Neni 7

Kërkesa për masa të veçanta

1. Një autoritet qendror mund t'i bëjë një kërkesë të arsyetuar një autoriteti tjetër qendror për të marrë masa të nevojshme të veçanta sipas nenit 6 (2) "b", "c", "g", "h", "i" dhe "j" kur asnjë kërkesë sipas nenit 10, nuk është përfunduar. Autoriteti qendror i kërkuar merr masat e duhura nëse çmon se ato janë të nevojshme për të ndihmuar një kërkuar potencial në bërjen e një kërkesë, sipas nenit 10 ose për përcaktimin nëse një kërkesë duhet të paraqitet.
2. Një autoritet qendror mund të marrë masa të veçanta për kërkesën e një autoriteti tjetër qendror mbi një çështje që ka një element ndërkombëtar në lidhje me rivendosjen e detyrimit ushqimor, që nuk ka përfunduar në shtetin kërkuar.

Neni 8

Shpenzimet e autoritetit qendror

1. Çdo autoritet qendror përballon shpenzimet e veta në zbatimin e kësaj Konvente.
2. Autoritetet qendrore nuk mund të vendosin detyrime financiare ndaj një kërkuesi për ofrimin e shërbimeve të tyre sipas Konventës, përveç shpenzimeve përjashtimore, që lindin nga një kërkesë për masë specifike sipas nenit 7.
3. Autoriteti i kërkuar qendror nuk mund të kompensojë kostot e shërbimeve të përmendura në paragrafin 2, pa miratimin paraprak të kërkuesit për ofrimin e këtyre shërbimeve me këto kosto.

KAPITULLI III

KËRKESAT NËPËRMJET AUTORITETEVE QENDRORE

Neni 9

Kërkesa nëpërmjet autoriteteve qendrore

Një kërkesë sipas këtij kapitulli bëhet nëpërmjet autoritetit qendror të shtetit kontraktues në të cilin banon kërkuesi, për autoritetin qendror të shtetit të kërkuar. Për qëllimin e kësaj dispozite, vendbanimi përjashton praninë e thjeshtë.

Neni 10

Kërkesat e vëna në dispozicion

1. Kategoritë e mëposhtme të kërkesave i vihen në dispozicion një kreditori në një shtet kërkues, që synon të rivendosë mbështetjen financiare sipas kësaj Konvente.

- a) njohja ose njohja dhe ekzekutimi i një vendimi;
- b) zbatimi i një vendimi të marrë ose të njohur në shtetin e kërkuar;
- c) marrja e një vendimi në shtetin e kërkuar ku nuk ka vendim ekzistues, duke përfshirë nëse është e nevojshme, përcaktimin e ushtrimit të përgjegjësisë prindërore;
- d) marrja e një vendimi në shtetin e kërkuar kur njohja dhe zbatimi i një vendimi nuk është e mundur ose refuzohet për shkak të mungesës së një baze për njohjen dhe zbatimin sipas nenit 20 ose për arsye të përcaktuara në nenin 22 “b” ose “e”;
- e) ndryshimi i një vendimi të marrë në shtetin e kërkuar;
- f) ndryshimi i një vendimi të marrë në një shtet të ndryshëm nga shteti i kërkuar.

2. Kategoritë e mëposhtme të kërkesave i vihen në dispozicion një debitori në shtetin kërkues kundër të cilit ka një vendim ekzistues për detyrim ushqimor:

- a) njohja e një vendimi ose procedure të barasvlershme që çon në pezullimin ose kufizimin e zbatimit të një vendimi të mëparshëm në shtetin e kërkuar;
- b) ndryshimi i një vendimi të marrë në shtetin e kërkuar;
- c) ndryshimi i një vendimi të marrë në një shtet të ndryshëm nga shteti i kërkuar.

3. Përveç rasteve kur parashikohet ndryshe në këtë Konventë, kërkesat në paragrafët 1 dhe 2 përcaktohen sipas ligjit të shtetit të kërkuar, dhe kërkesat në paragrafët 1 “c”

deri “f” dhe 2 “b” dhe “c”, u nënshtrohen rregullave juridiksionale të zbatueshme në shtetin e kërkuar.

Neni 11

Përmbajtja e kërkesës

1. Të gjitha kërkesat sipas nenit 10 do të përfshijnë minimalisht:

- a) një deklaratë të natyrës së kërkesës ose kërkesave;
- b) emrin dhe detajet e kontaktit, duke përfshirë adresën dhe datën e lindjes së kërkuarit;
- c) emrin dhe nëse ka informacion, adresën dhe datën e lindjes së palës së paditur;
- d) emrin dhe datën e lindjes së çdo personi për të cilin kërkohen detyrimet ushqimore;
- e) arsyet në të cilat bazohet kërkesa;
- f) në një kërkesë nga kreditori, informacion në lidhje me faktin se ku duhet të dërgohet ose transmetohet në rrugë elektronike pagesa e detyrimit ushqimor;
- g) përveç një kërkesë sipas nenit 10 (1) “a” dhe (2) “a”, çdo informacion ose dokument të përcaktuar me deklaratë, në përputhje me nenin 63, nga shteti i kërkuar;
- h) emrin dhe detajet e kontaktit të personit ose njësisë nga autoriteti qendror i shtetit kërkuar përgjegjës për trajtimin e kërkesës.

2. Nëse është e përshtatshme dhe në masën që dihet, kërkesa duhet të përfshijë edhe:

- a) rrethanat financiare të kreditorit;
- b) rrethanat financiare të debitorit, duke përfshirë emrin dhe adresën e punëdhënësit të debitorit dhe natyrën dhe vendndodhjen e asetëve të debitorit;
- c) çdo informacion tjetër që mund të ndihmojë në përcaktimin e vendndodhjes së të paditurit.

3. Kërkesa shoqërohet nga çdo informacion ose dokumentacion mbështetës i nevojshëm, duke përfshirë dokumentacionin në lidhje me të drejtën e kërkuarit për ndihmë ligjore falas. Në rast të kërkesave sipas nenit 10(1) “a” dhe (2) “a”, kërkesa shoqërohet vetëm nga dokumentet e renditura në nenin 25.

4. Një kërkesë sipas nenit 10 mund të bëhet në formën e rekomanduar dhe publikuar nga Konferenca e Hagës për të Drejtën Private Ndërkombëtare.

Neni 12

Transmetimi, marrja dhe trajtimi i kërkesave dhe çështjeve nëpërmjet autoriteteve qendrore

1. Autoriteti qendror i shtetit kërkuar ndihmon kërkuarin për të garantuar që kërkesa të shoqërohet nga i gjithë informacioni dhe dokumentet për të cilat është në dijeni se janë të nevojshme për shqyrtimin e kërkesës.

2. Autoriteti qendror i shtetit kërkuar, kur çmon se kërkesa pajtohet me kërkesat e Konventës, transmeton kërkesën në emër të dhe me pëlqimin e autoritetit qendror të shtetit të kërkuar. Kërkesa shoqërohet nga një formular transmetimi i përcaktuar në shtojcën 1. Autoriteti qendror i shtetit kërkuar, nëse kërkohet nga autoriteti qendror i shtetit të kërkuar, siguron një kopje të plotë të vërtetuar nga autoriteti kompetent në shtetin e origjinës të çdo dokumenti të përcaktuar sipas neneve 16(3), 25(1) “a”, “b” dhe “d” dhe (3) “b” dhe 30(3).

3. Autoriteti qendror i kërkuar, brenda gjashtë javësh nga data e marrjes së kërkesës, konfirmon marrjen në formën e përcaktuar në shtojcën 2 dhe informon autoritetin qendror të shtetit kërkuar se cilët hapa fillestarë janë marrë ose do të merren për trajtimin e kërkesës, dhe mund të kërkojë çdo dokument dhe informacion tjetër të nevojshëm. Brenda së njëjtës periudhë gjashtë javore, autoriteti qendror i kërkuar i jep autoritetit qendror kërkuar emrin dhe

informacionet e

kontaktit të personit ose njësisë përgjegjëse për përgjigjen ndaj kërtimeve në lidhje me ecurinë e kërkesës.

4. Brenda tre muajve pas konfirmimit, autoriteti qendror i kërkuar informon autoritetin qendror kërkuar për statusin e kërkesës.

5. Autoritetet kërkuar dhe të kërkuara informojnë njëri-tjetrin për:

- a) personin ose njësinë përgjegjëse për një çështje të caktuar;
- b) ecurinë e çështjes; dhe japin përgjigje në kohë për kërkimet.

6. Autoritetet qendrore trajtojnë një çështje aq shpejt sa e lejon një shqyrtim i duhur i çështjeve.

7. Autoritetet qendrore përdorin mjetet e komunikimit më të shpejta dhe efektive në dispozicion të tyre.

8. Një autoritet qendror i kërkuar mund të refuzojë trajtimin e një kërkesë vetëm nëse është

e qartë se kërkesat e Konventës nuk janë përmbushur. Në këtë rast, ky autoritet qendror informon menjëherë autoritetin qendror kërkuar për arsyet e tij të refuzimit.

9. Autoriteti qendror i kërkuar nuk mund të refuzojë një kërkesë vetëm për shkakun se nevojiten dokumente ose informacion shtesë. Megjithatë, autoriteti qendror i kërkuar mund t'i kërkojë autoritetit qendror kërkuar ofrimin e këtyre dokumenteve ose informacionit shtesë. Nëse autoriteti qendror kërkuar nuk e bën këtë brenda tre muajve ose një periudhe më të gjatë, të përcaktuar nga autoriteti qendror i kërkuar, autoriteti qendror i kërkuar mund të vendosë që të mos e trajtojë më kërkesën. Në këtë rast, ai informon për këtë vendim autoritetin qendror kërkuar.

Neni 13

Mjetet e komunikimit

Çdo kërkesë e bërë nëpërmjet autoriteteve qendrore të shteteve kontraktuese në përputhje me këtë kapitull dhe çdo dokument ose informacion që i bashkëlidhet ose sigurohet nga një autoritet qendror, nuk mund të kundërshtohet nga i padituri vetëm për shkak të mjetit të informimit ose komunikimit, të përdorur nga autoritet qendror të interesuara.

Neni 14

Aksesi efektiv në procedura

1. Shteti i kërkuar u jep kërkuarve akses efektiv në procedura, duke përfshirë procedurat e aplikimit dhe të ekzekutimit, që lindin nga kërkesat sipas këtij kapitulli.

2. Për të siguruar këtë akses efektiv, shteti i kërkuar siguron ndihmë ligjore falas në përputhje me nenet 14 deri 17, nëse nuk zbatohet paragrafi 3.

3. Shteti i kërkuar nuk është i detyruar të ofrojë këtë ndihmë ligjore falas nëse dhe në masën që procedurat e këtij shteti i mundësojnë kërkuarit të paraqesë çështjen pa nevojën e kësaj ndihme, dhe autoriteti qendror siguron këto shërbime të nevojshme pa pagesë.

4. Të drejtat për ndihmë ligjore falas nuk do të jenë më pak të kufizuara sesa ato që vihen në dispozicion në raste të ngjashme të brendshme.

5. Asnjë letër me vlerë, obligacion ose depozitë, sido që të përshkruhet, nuk kërkohet për të garantuar pagesën e kostove dhe shpenzimeve në procedimet sipas Konventës.

Neni 15

Ndihma ligjore falas për kërkesat e mbështetjes ndaj fëmijës

1. Shteti i kërkuar ofron ndihmë ligjore falas në lidhje me të gjitha kërkesat nga një kreditor, sipas këtij kapitulli mbi detyrimet ushqimore që lindin nga një marrëdhënie prind-fëmijë ndaj një personi nën moshën 21 vjeç.

2. Pavarësisht nga paragrafi 1, në lidhje me kërkesat e ndryshme nga ato që parashikohen në nenin 10(1) “a” dhe “b” dhe çështjet e mbuluara nga neni 20(4), shteti i kërkuar mund të refuzojë ndihmën ligjore falas nëse çmon se, në themel, kërkesa ose apeli është haptazi e/i pabazuar.

Neni 16

Deklarata për të lejuar testimin e mjeteve të jetesës së përqendruar te fëmija

1. Pavarësisht nga neni 15(1) një shtet mund të deklarojë, në përputhje me nenin 63, se do të ofrojë ndihmë ligjore falas në lidhje me kërkesat e ndryshme nga ato që parashikohen në nenin 10(1) a) dhe b) dhe çështjet e mbuluara nga neni 20(4), në bazë të një testi, të bazuar në një vlerësim të mjeteve të fëmijës.

2. Në kohën e bërjes së kësaj deklarate, një shtet i jep informacion Zyrës së Përhershme të Konferencës së Hagës për të Drejtën Private Ndërkombëtare në lidhje me mënyrën në të cilën do të kryhet vlerësimi i mjeteve të fëmijës, duke përfshirë kriteret financiare që duhet të plotësoheshin për realizimin e testit.

3. Një kërkesë e përmendur në paragrafin 1, e drejtuar ndaj një shteti që ka bërë një deklaratë të përmendur në këtë paragraf, përfshin një vërtetim formal nga kërkuesi që deklaron se mjetet e fëmijës plotësojnë kriteret e përmendura në paragrafin 2. Shteti i kërkuar mund të kërkojë vetëm prova të mëtejshme të mjeteve të fëmijës, nëse ka arsye të besojë se informacioni i dhënë nga kërkuesi është i pasaktë.

4. Nëse ndihma ligjore më e favorshme, e parashikuar me ligjin e shtetit të kërkuar në lidhje me kërkesat sipas këtij kapitulli mbi detyrimet ushqimore, që lindin nga një marrëdhënie prindfëmijë ndaj një fëmije, është më e favorshme sesa ajo e parashikuar në paragrafët 1 deri 3, ofrohet ndihma ligjore më e favorshme.

Neni 17

Kërkesat që nuk kualifikohen sipas nenit 15 ose nenit 16 Në rast të të gjitha kërkesave sipas kësaj Konvente, të ndryshme nga ato që parashikohen në nenin 15 ose nenin 16:

a) ndihma ligjore falas mund t’i nënshtrohet një testi mjetesh ose meritash;

b) një kërkues, i cili në shtetin e origjinës ka përfituar nga ndihma ligjore falas, ka të drejtë në çdo procedim për njohje ose zbatim, të përfitojë, të paktën në të njëjtën masë, nga ndihma ligjore falas e parashikuar me ligjin e shtetit të adresuar, sipas rrethanave të njëjta.

KAPITULLI IV KUFIZIMET PËR PARAQITJEN E PROCEDIMEVE

Neni 18

Kufizimet e procedimeve

1. Kur një vendim merret në një shtet kontraktues, ku kreditori ka vendbanimin e zakonshëm, procedimet për të ndryshuar vendimin ose për të marrë një vendim të ri, nuk mund të paraqiten nga debitori në një shtet tjetër kontraktues për aq kohë sa kreditori ka vendbanimin e zakonshëm në shtetin ku është marrë vendimi.

2. Paragrafi 1 nuk zbatohet:

a) kur, përveç rasteve të mosmarrëveshjeve mbi detyrimet ushqimore në lidhje me fëmijët, ka marrëveshje me shkrim ndërmjet palëve të juridiksionit të atij shteti tjetër kontraktues;

- b) kur kreditori i nënshtrohet juridiksionit të atij shteti tjetër kontraktues ose shprehimisht, ose duke mbrojtur çështjen në themel pa kundërshtuar juridiksionin në rastin më të parë të mundshëm;
- c) kur autoriteti kompetent në shtetin e origjinës nuk mund ose refuzon të ushtrojë juridiksion për të ndryshuar vendimin ose për të marrë një vendim të ri; ose
- d) kur vendimi i marrë në shtetin e origjinës nuk mund të njihet ose shpallet i ekzekutueshëm në shtetin kontraktues ku shqyrtohen procedimet për ndryshimin e vendimit ose për marrjen e një vendimi të ri.

KAPITULLI V NJOHJA DHE EKZEKUTIMI

Neni 19

Objekti i kapitullit

1. Ky kapitull zbatohet për një vendim të dhënë nga një autoritet gjyqësor ose administrativ në lidhje me një detyrim ushqimor. Termi “vendim” përfshin, gjithashtu, një kontratë ose marrëveshje të lidhur më parë ose të miratuar nga ky autoritet. Një vendim mund të përfshijë rregullimin automatik me anë të indeksimit dhe një kërkesë për të paguar shumat e prapambetura, mbështetjen financiare ose interesin prapaveprues dhe një përcaktim të kostove ose shpenzimeve.
2. Nëse një vendim nuk ka lidhje vetëm me një detyrim ushqimor, ndikimi i këtij kapitulli kufizohet në pjesët e vendimit që kanë lidhje me detyrimet ushqimore.
3. Për qëllim të paragrafit 1, “autoriteti administrativ” nënkupton një organ publik vendimet e të cilit, sipas ligjit të shtetit ku është krijuar:
 - a) mund t’i nënshtrohen një apeli ose rishikimi nga një autoritet gjyqësor; dhe
 - b) kanë një fuqi dhe efekt të ngjashëm me një vendim të një autoriteti gjyqësor për të njëjtën çështje.
4. Ky kapitull zbatohet edhe për marrëveshjet e mbështetjes financiare, në përputhje me nenin 30.
5. Dispozitat e këtij kapitulli zbatohen për një kërkesë për njohje dhe ekzekutim të bërë drejtpërdrejt një autoriteti kompetent të shtetit të adresuar, në përputhje me nenin 37.

Neni 20

Bazat për njohjen dhe ekzekutimin

1. Një vendim i marrë në një shtet kontraktues (shteti i origjinës) njihet dhe ekzekutohet në shtete të tjera kontraktuese, nëse:
 - a) i padituri ka pasur vendbanimin e zakonshëm në shtetin e origjinës në kohën kur kanë filluar procedimet;
 - b) i padituri i nënshtrohet juridiksionit ose shprehimisht, ose duke mbrojtur çështjen në themel pa kundërshtuar juridiksionin në rastin më të parë të mundshëm;
 - c) kreditori ka pasur vendbanimin e zakonshëm në shtetin e origjinës në kohën kur kanë filluar procedimet;
 - d) fëmija për të cilin është urdhëruar detyrimi ushqimor ka pasur vendbanimin e zakonshëm në shtetin e origjinës në kohën kur kanë filluar procedimet, me kusht që i padituri të ketë jetuar me fëmijën në atë shtet ose të ketë banuar në atë shtet dhe të ketë ofruar mbështetje për fëmijën atje;
 - e) përveç rasteve të mosmarrëveshjeve mbi detyrimet e mbështetjes financiare në lidhje me fëmijët, ka pasur marrëveshje me shkrim për juridiksionin nga palët; ose
 - f) vendimi është marrë nga një autoritet që ushtron juridiksion për një çështje me status personal ose përgjegjësi prindërore, nëse juridiksioni nuk është bazuar vetëm në

kombësinë e një prej palëve.

2. Një shtet kontraktues mund të bëjë një rezervë, në përputhje me nenin 62, në lidhje me

paragrafin 1 “c”, “e” ose “f”.

3. Një shtet kontraktues që bën një rezervë sipas paragrafit 2, njeh dhe ekzekuton një vendim nëse ligji i tij në rrethana faktike të ngjashme, do t’i jepte ose do t’i kishte dhënë juridiksion autoriteteve të tij për marrjen e këtij vendimi.

4. Nëse njohja e një vendimi nuk është e mundur si rezultat i një rezerve sipas paragrafit 2, dhe nëse debitori ka vendbanimin e zakonshëm në atë shtet, një shtet kontraktues do të marrë të gjitha masat e duhura për marrjen e një vendimi në interes të kreditorit. Fjalja pararendëse nuk zbatohet për kërkesat e drejtpërdrejta për njohje dhe zbatim sipas nenit 19(5) ose për kërkesat për mbështetje të përmendura në nenin 2(1) “b”.

5. Një vendim në favor të një fëmije nën moshën 18 vjeç, që nuk mund të njihet vetëm në bazë të një rezerve në lidhje me paragrafin 1 “c”, “e” ose “f”, pranohet se përcakton pranueshmërinë e atij fëmije për mbështetje financiare në shtetin e adresuar.

6. Një vendim njihet vetëm nëse ka fuqi në shtetin e origjinës dhe ekzekutohet vetëm nëse është i ekzekutueshëm në shtetin e origjinës.

Neni 21

Vlefshmëria e pjeshme dhe njohja e ekzekutimi i pjesshëm

1. Nëse shteti i adresuar nuk është i aftë të njohë ose zbatojë të gjithë vendimin, ai do të njohë ose zbatojë çdo pjesë të veçantë të vendimit që mund të njihet ose zbatohet në këtë mënyrë.

2. Njohja ose ekzekutimi i pjesshëm i një vendimi mund të kërkohet në çdo rast.

Neni 22

Arsyet për refuzimin e njohjes dhe zbatimit

Njohja dhe ekzekutimi i një vendimi mund të refuzohet nëse:

a) njohja dhe zbatimi i vendimit janë haptazi të papajtueshme me politikën publike (ordre public) të shtetit të adresuar;

b) vendimi është marrë me anë të mashtrimit në lidhje me një çështje procedurale;

c) procedimet midis palëve të njëjta dhe që kanë të njëjtin qëllim kanë mbetur pezull para një autoriteti të shtetit të adresuar dhe këto procedime kishin filluar më parë;

d) vendimi është i papajtueshëm me një vendim të dhënë midis palëve të njëjta dhe që kanë të njëjtin qëllim, ose në shtetin e adresuar ose në një shtet tjetër, me kusht që ky vendim i fundit të përmbushë kushtet e nevojshme për njohjen dhe zbatimin e tij në shtetin e adresuar;

e) në një rast kur i padituri nuk është paraqitur dhe as nuk është përfaqësuar në procedime në shtetin e origjinës:

i) kur ligji i shtetit të origjinës parashikon njoftimin e procedimeve, i padituri nuk ishte njoftuar për procedimet dhe nuk kishte mundësi për t’u dëgjuar; ose

ii) kur ligji i shtetit të origjinës nuk parashikon njoftimin e procedimeve, i padituri nuk ishte njoftuar për vendimin dhe nuk kishte mundësi për ta kundërshtuar ose apeluar atë në bazë të fakteve dhe ligjit;

f) vendimi është marrë në shkelje të nenit 18.

Neni 23

Procedura për një kërkesë për njohje dhe ekzekutim

1. Në bazë të dispozitave të Konventës, procedurat për njohje dhe ekzekutim rregullohen nga ligji i shtetit të adresuar.
2. Kur një kërkesë për njohje dhe zbatim të një vendimi është bërë nëpërmjet autoriteteve qendrore në përputhje me kapitullin III, autoriteti qendror i kërkuar menjëherë:
 - a) i drejton kërkesën autoritetit kompetent, i cili, pa vonesë shpall vendimin të ekzekutueshëm ose regjistron vendimin për zbatim; ose
 - b) nëse është autoriteti kompetent, i ndërmerr vetë këta hapa.
3. Kur kërkesa i bëhet drejtpërdrejt një autoriteti kompetent në shtetin e adresuar në përputhje me nenin 19(5), ky autoritet shpall pa vonesë vendimin, të zbatueshëm ose regjistron vendimin për zbatim.
4. Një deklaratë ose regjistrim mund të refuzohet vetëm për arsyen e përcaktuar në nenin 22 “a”. Në këtë fazë as kërkuesi, as i padituri nuk kanë të drejtë për të bërë parashtrime.
5. Kërkuesi dhe i padituri njoftohen menjëherë për deklaratën ose regjistrimin e bërë sipas paragrafëve 2 dhe 3, ose refuzimin e tyre në përputhje me paragrafin 4, dhe mund të paraqesin një kërkesë për mospranim ose apel në bazë të fakteve dhe një argument ligjor.
6. Një kërkesë për mospranim ose apel duhet të depozitohet brenda 30 ditëve nga njoftimi sipas paragrafit 5. Nëse pala kundërshtuese nuk është rezidente në shtetin kontraktues në të cilin është bërë ose refuzuar deklarata ose regjistrimi, kërkesa për mospranim ose apel do të paraqitet brenda 60 ditëve nga njoftimi.
7. Një kërkesë për mospranim ose apel mund të bazohet vetëm në sa më poshtë:
 - a) arsyet për refuzimin e njohjes dhe zbatimit të përcaktuara në nenin 22;
 - b) bazat për njohjen dhe zbatimin sipas nenit 20;
 - c) ligjshmëria ose saktësia e ndonjë dokumenti të transmetuar në përputhje me nenin 25(1) “a”, b) ose d) ose (3) “b”.
8. Një kërkesë për mospranim ose apel nga një i paditur mund të bazohet edhe në mbarimin e afatit të borxhit në masën që njohja dhe zbatimi kanë lidhje me pagesat, të cilave u ka kaluar afati në të shkuarën.
9. Kërkuesi dhe i padituri njoftohen menjëherë për vendimin, pas kërkesës për mospranim ose apelit.
10. Një apel i mëtejshëm, nëse lejohet me ligjin e shtetit të adresuar, nuk ka efektin e shtyrjes së zbatimit të vendimit nëse nuk ka rrethana të jashtëzakonshme.
11. Në marrjen e një vendimi për njohjen dhe zbatimin, duke përfshirë çdo apel, autoriteti kompetent vepron me shpejtësi.

Neni 24

Procedura alternative për një kërkesë për njohje dhe ekzekutim

1. Pavarësisht nga neni 23(2) deri (11), një shtet mund të deklarojë në përputhje me nenin 63, se do të zbatojë procedurën për njohjen dhe ekzekutimin, të përcaktuar në këtë nen.
2. Kur është bërë një kërkesë për njohje dhe zbatim nëpërmjet autoriteteve qendrore në përputhje me kapitullin III, autoriteti qendror i kërkuar menjëherë:
 - a) i drejton kërkesën autoritetit kompetent, që vendos mbi kërkesën për njohje dhe ekzekutim; ose
 - b) nëse është autoriteti kompetent, e merr vetë këtë vendim.
3. Një vendim për njohje dhe ekzekutim jepet nga autoriteti kompetent, pasi i padituri të jetë njoftuar menjëherë dhe sipas rregullave për procedurat dhe të dyja palëve t’u jetë dhënë një mundësi e mjaftueshme për t’u dëgjuar.
4. Autoriteti kompetent mund të rishikojë arsyet për refuzimin e njohjes dhe

ekzekutimit të përcaktuara në nenin 22 “a”, “c” dhe “d” me mocionin e vet. Ai mund të rishikojë arsyet e renditura në nenet 20, 22 dhe 23(7) “c”, nëse paraqiten nga i padituri ose nëse lindin probleme në lidhje me këto arsye nga paraqitja e dokumenteve të paraqitura në përputhje me nenin 25.

5. Një refuzim i njohjes dhe ekzekutimit mund të bazohet edhe në mbarimin e afatit të borxhit në masën që njohja dhe ekzekutimi kanë lidhje me pagesat, të cilave u ka kaluar afati në të shkuarën.

6. Çdo apel, nëse lejohet nga ligji i shtetit të adresuar, nuk ka efektin e shtyrjes së zbatimit të vendimit nëse nuk ka rrethana të jashtëzakonshme.

7. Në marrjen e një vendimi për njohje dhe ekzekutim, duke përfshirë çdo apel, autoriteti kompetent vepron me shpejtësi.

Neni 25 **Dokumentet**

1. Një kërkesë për njohje dhe ekzekutim sipas nenit 23 ose nenit 24 shoqërohet nga sa më poshtë:

a) një tekst të plotë të vendimit;

b) një dokument që deklaron se vendimi është i ekzekutueshëm në shtetin e origjinës dhe, në rast të një vendimi nga një autoritet administrativ, një dokument që deklaron se kërkesat e nenit 19(3) janë përmbushur, nëse ai shtet nuk ka përcaktuar në përputhje me nenin 57 se vendimet e autoriteteve të tij administrative plotësojnë këto kërkesa në çdo rast;

c) nëse i padituri nuk është paraqitur dhe nuk është përfaqësuar në procedimet gjyqësore në shtetin e origjinës, një dokument ose dokumente që vërtetojnë, sipas rastit, se i padituri është njoftuar për procedimet gjyqësore dhe ka pasur mundësi për t'u dëgjuar, ose se i padituri është njoftuar për vendimin dhe ka pasur mundësinë për ta kundërshtuar ose apeluar atë në bazë të fakteve dhe ligjit;

d) kur është e nevojshme, një dokument që tregon shumën e pagesave të prapambetura dhe datën kur kjo shumë është llogaritur;

e) kur është e nevojshme, në rastin e një vendimi që parashikon rregullimin e menjëhershëm me indeksim, një dokument që ofron informacionin e nevojshëm për bërjen e llogarive të duhura;

f) kur është e nevojshme, dokumentacion që tregon masën në të cilën kërkuesi ka marrë ndihmë ligjore falas në shtetin e origjinës.

2. Pas një kërkesë për mospranim ose apel, sipas nenit 23(7) “c” ose me kërkesën e autoritetit kompetent në shtetin e adresuar, një kopje e plotë e dokumentit përkatës, e vërtetuar nga autoriteti kompetent në shtetin e origjinës, sigurohet menjëherë:

a) nga autoriteti qendror i shtetit kërkues, kur kërkesa është bërë në përputhje me kapitullin III;

b) nga kërkuesi, kur kërkesa i është bërë drejtpërdrejt një autoriteti kompetent të shtetit të adresuar.

3. Një shtet kontraktues mund të përcaktojë në përputhje me nenin 57:

a) se një kopje e plotë e vendimit të vërtetuar nga autoriteti kompetent në shtetin e origjinës duhet të shoqërojë kërkesën;

b) rrethanat në të cilat ai do të pranojë, në vend të një teksti të plotë të vendimit, një përmbledhje ose pjesë të vendimit të hartuar nga autoriteti kompetent i shtetit të origjinës, që mund të bëhet në formën e rekomanduar dhe publikuar nga Konferenca e Hagës për të Drejtën Private Ndërkombëtare; ose

c) se nuk kërkon një dokument që deklaron përmbushjen e kërkesave të nenit 19(3).

Neni 26
Procedura e kërkesës për njohje

Ky kapitull zbatohet mutatis mutandis ndaj një kërkesë për njohjen e një vendimi, përveç rasteve kur kërkesa e ekzekutueshmërisë zëvendësohet nga kërkesa që vendimi ka fuqi në shtetin e origjinës.

Neni 27
Përfundimet e fakteve

Çdo autoritet kompetent i shtetit të adresuar është i detyruar nga përfundimet e fakteve në të cilat autoriteti i shtetit të origjinës ka bazuar juridiksionin e tij.

Neni 28
Mosshqyrtimi në themel

Nuk do të ketë asnjë shqyrtim nga ndonjë autoritet kompetent të shtetit të adresuar, të themelit të një vendimi.

Neni 29
Moskërkimi i pranisë fizike të fëmijës ose kërkuesit

Prania fizike e fëmijës ose kërkuesit nuk kërkohet në çdo procedim gjyqësor në shtetin e adresuar sipas këtij kapitulli.

Neni 30
Marrëveshjet e detyrimit ushqimor

1. Një marrëveshje për detyrim ushqimor, e bërë në një shtet kontraktues, do të jetë objekt njohjeje dhe ekzekutimi, sikurse një vendim sipas këtij kapitulli, me kusht që ajo të jetë e ekzekutueshme në vendin e shtetit të origjinës.
2. Për qëllim të nenit 10(1) “a” dhe “b” dhe (2) “a”, termi “vendim” përfshin një marrëveshje për detyrim ushqimor.
3. Një kërkesë për njohje dhe ekzekutim të një marrëveshjeje për detyrime ushqimore do të shoqërohet nga:
 - a) një tekst i plotë i marrëveshjes së detyrimit ushqimor; dhe
 - b) një dokument që deklaron se marrëveshja e veçantë e detyrimit ushqimor është e ekzekutueshme si vendim në shtetin e origjinës.
4. Njohja dhe ekzekutimi i një marrëveshjeje për detyrim ushqimor mund të refuzohet nëse:
 - a) njohja dhe ekzekutimi janë haptazi të papajtueshme me politikat publike të shtetit të adresuar;
 - b) marrëveshja e detyrimit ushqimor është realizuar me anë të mashtrimit ose falsifikimit;
 - c) marrëveshja e detyrimit ushqimor nuk pajtohet me një vendim të dhënë ndërmjet palëve të njëjta dhe që kanë të njëjtin qëllim, ose në shtetin e adresuar ose në një shtet tjetër, me kusht që ky vendim i fundit të përmbushë kushtet e nevojshme për njohjen dhe zbatimin e tij në shtetin e adresuar.
5. Dispozitat e këtij kapitulli, me përjashtim të neneve 20, 22, 23(7) dhe 25(1) dhe (3) zbatohen mutatis mutandis për njohjen dhe zbatimin e një marrëveshjeje të

mbështetjes financiare, përveç rasteve kur:

a) një deklaratë ose regjistrim në përputhje me nenin 23(2) dhe (3) mund të refuzohet vetëm

për arsyen e përcaktuar në paragrafin 4 “a”;

b) një kundërshtim ose apel i përmendur në nenin 23(6) mund të bazohet vetëm për sa më poshtë:

i) arsyet për refuzimin e njohjes dhe zbatimit, të përcaktuara në paragrafin 4;

ii) origjinalitetin ose saktësinë e çdo dokumenti të transmetuar në përputhje me paragrafin 3;

c) për sa i përket procedurës sipas nenit 24(4), autoriteti kompetent mund të rishikojë, me mocionin e vet, arsyen për refuzimin e njohjes dhe zbatimit të përcaktuar në paragrafin 4 “a” të këtij neni. Ai mund të rishikojë të gjitha arsyet e renditura në paragrafin 4 të këtij neni dhe ligjshmërinë ose saktësinë e çdo dokumenti të transmetuar në përputhje me paragrafin 3, nëse paraqitet nga i padituri ose nëse ka lidhje me arsyet që lindin nga paraqitja e këtyre dokumenteve.

6. Procedimet për njohjen dhe zbatimin e një marrëveshjeje për mbështetjen financiare do të pezullohen nëse një kërkesë për mospranim në lidhje me marrëveshjen ka mbetur pezull para një autoriteti kompetent të një shteti kontraktues.

7. Një shtet mund të deklarojë, në përputhje me nenin 63, se kërkesat për njohjen dhe zbatimin e një marrëveshjeje për mbështetje financiare bëhen vetëm nëpërmjet autoriteteve qendrore.

8. Një shtet kontraktues, në përputhje me nenin 62, mund të rezervojë të drejtën për të mos njohur dhe zbatuar një marrëveshjeje për mbështetjen financiare.

Neni 31

Vendimet e marra nga efekti i kombinuar i urdhrave të përkohshëm dhe konfirmues Kur një vendim është marrë nga efekti i kombinuar i një urdhri të përkohshëm, të marrë në një shtet dhe një urdhri nga një autoritet në një shtet tjetër (shteti konfirmues), që konfirmon urdhrin e përkohshëm:

a) secili prej këtyre shteteve konsiderohet, për qëllimet e këtij kapitulli, të jetë një shtet origjine;

b) kërkesat e nenit 22 “e” do të përmbushen nëse i padituri është njoftuar për procedimet në shtetin konfirmues dhe ka pasur një mundësi për të kundërshtuar konfirmimin e urdhrin të përkohshëm;

c) kërkesa e nenit 20(6), që një vendim të jetë i zbatueshëm në shtetin e origjinës, do të përmbushet nëse vendimi është i zbatueshëm në shtetin konfirmues; dhe

d) neni 18 nuk pengon procedimet për ndryshimin e vendimit që fillojnë në çdo shtet.

KAPITULLI VI EKZEKUTIMI NGA SHETI I ADRESUAR

Neni 32

Ekzekutimi sipas ligjit të brendshëm

1. Në bazë të dispozitave të këtij kapitulli, ekzekutimi kryhet në përputhje me ligjin e shtetit të adresuar.

2. Ekzekutimi është i menjëhershëm.

3. Në rast të kërkesave nëpërmjet autoriteteve qendrore, kur një vendim është shpallur i ekzekutueshëm ose i regjistruar për ekzekutim sipas kapitullit V, ekzekutimi vijon pa nevojën për veprim të mëtejshëm nga kërkuesi.

4. Çdo rregull i zbatueshëm në shtetin e origjinës për vendimin në lidhje me kohëzgjatjen e detyrimit ushqimor, i jepet fuqi ligjore.

5. Çdo parashkrim i periudhës për të cilën mund të zbatohen pagesat e prapambetura

përcaktohet ose nga ligji i shtetit të origjinës së vendimit, ose nga ligji i shtetit të adresuar, cilido që parashikon periudhën më të gjatë të parashkrimit.

Neni 33

Mosdiskriminimi

Shteti i adresuar minimalisht ofron të njëjtat metoda ekzekutimi për çështjet sipas Konventës, të cilat janë të zbatueshme dhe për çështjet që rregullohen nga legjislati i brendshëm.

Neni 34

Masat zbatuese

1. Shtetet kontraktuese vënë në dispozicion në ligjin e brendshëm masa efektive për ekzekutimin e vendimeve sipas kësaj Konvente.
2. Këto masa mund të përfshijnë:
 - a) mbajtjen nga paga;
 - b) konfiskim i pasurisë së një personi të tretë nga llogaritë bankare dhe burime të tjera;
 - c) zbritjet nga pagesat e sigurimeve shoqërore;
 - d) barrën mbi ose shitjen e detyruar të pronës;
 - e) ndalesën në rimbursimin e taksave;
 - f) ndalesën ose konfiskimin e përfitimeve të pensionit;
 - g) raportimin në zyrën e kredisë;
 - h) mohimin, pezullimin ose anulimin e licencave të ndryshme (për shembull, lejet e drejtimit të mjetit);
 - i) përdorimin e ndërmjetësimit, pajtimit ose proceseve të ngjashme me qëllimin e pajtueshmërisë vullnetare.

Neni 35

Transferimi i fondeve

1. Shtetet kontraktuese inkurajohen të nxisin, duke përfshirë me anë të marrëveshjeve ndërkombëtare, përdorimin e metodave më ekonomike dhe efektive të vëna në dispozicion për transferimin e fondeve të pagueshme si mbështetje financiare.
2. Një shtet kontraktues, sipas ligjit të të cilit transferohet transferimi i fondeve, i jep prioritetin më të lartë transferimit të fondeve të pagueshme sipas kësaj Konvente.

KAPITULLI VII ORGANET PUBLIKE

Neni 36

Organet publike si kërkuese

1. Për qëllimet e kërkesave për njohje dhe ekzekutim sipas nenit 10(1) “a” dhe “b” dhe çështjet e mbuluara nga neni 20(4), “kreditori” përfshin një organ publik që vepron në vend të një individi, i cili duhet të përfitojë detyrim ushqimor ose detyrohet të përfitojë rimbursim për përfitimet e realizuara në vend të detyrimit ushqimor.
2. E drejta e një organi publik për të vepruar në vend të një individi, i cili gëzon të drejtën për detyrim ushqimor ose për të kërkuar rimbursim të përfitimeve të dhëna kreditorit në vend të detyrimit ushqimor, rregullohet nga ligji, të cilit i nënshtrohet organi.
3. Një organ publik mund të kërkojë njohjen ose të pretendojë zbatimin e:
 - a) një vendimi të dhënë kundër një debitori, me kërkesën e një organi publik që

pretendon pagesën e përfitimeve të dhëna në vend të detyrimit ushqimor;
b) një vendim të dhënë ndërmjet një kreditori dhe debitori në masën e përfitimeve të dhëna kreditorit në vend të detyrimit ushqimor.
4. Organi publik që kërkon njohjen ose pretendon ekzekutimin e një vendimi, me kërkesë, siguron çdo dokument të nevojshëm për të vendosur të drejtën e tij sipas paragrafit 2 dhe që përfitimet t'i jenë dhënë kreditorit.

KAPITULLI VIII DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 37

Kërkesa të drejtpërdrejta ndaj autoriteteve kompetente

1. Konventa nuk përjashton mundësinë e rekursit ndaj procedurave që mund të jenë të vlefshme, sipas ligjit të brendshëm të një shteti kontraktues, duke lejuar një person (kërkues) t'i drejtohet drejtpërdrejt një autoriteti kompetent të atij shteti në një çështje të rregulluar nga Konventa, duke përfshirë kërkesat e bëra në bazë të nenit 18, për qëllim të marrjes ose ndryshimit të një vendimi për detyrim ushqimor.
2. Nenet 4(5) dhe 17 b) dhe dispozitat e kapitujve V, VI, VII dhe këtij kapitulli, me përjashtim të neneve 40(2), 42, 43(3), 44(3), 45 dhe 55, zbatohen në lidhje me një kërkesë për njohje dhe ekzekutim të bërë drejtpërsëdrejti ndaj një autoriteti kompetent në një shtet kontraktues.
3. Për qëllimin e paragrafit 2, neni 2(1) "a" zbatohet për një vendim që i njej detyrimet ushqimore të një personi në nevojë mbi moshën e përcaktuar në këtë nënparagraf, nëse ky vendim ishte marrë para se personi të arrinte këtë moshë dhe parashikonte detyrim ushqimor, përtej asaj moshe për shkak të dëmtimit.

Neni 38

Mbrojtja e të dhënave personale

Të dhënat personale të mbledhura ose të transmetuara sipas Konventës, përdoren vetëm për qëllimin për të cilin janë mbledhur ose transmetuar.

Neni 39

Fshehtësia

Çdo autoritet që përpunon informacionin garanton fshehtësinë e tij në përputhje me ligjin e atij shteti.

Neni 40

Mosbulimi i informacionit

1. Një autoritet nuk do të zbulojë ose konfirmojë informacionin e mbledhur ose të transmetuar në zbatim të kësaj Konvente, nëse përcakton se një veprim i tillë mund të rrezikonte shëndetin, sigurinë ose lirinë e një personi.
2. Një parashikim për këtë qëllim i bërë nga një autoritet qendror merret në konsideratë nga autoriteti tjetër qendror, veçanërisht në rastet e dhunës në familje.
3. Asgjë në këtë nen nuk pengon mbledhjen dhe transmetimin e informacionit nga dhe ndërmjet autoriteteve në atë masë që të përmbushë detyrimet sipas Konventës.

Neni 41

Moslegalizimi

Asnjë legalizim ose formalitet i ngjashëm nuk mund të kërkohet në kontekstin e kësaj Konvente.

Neni 42 **Prokura**

Autoriteti qendror i shtetit të kërkuar mund të kërkojë një prokurë nga kërkuesi vetëm nëse vepron në emrin e tij ose të saj në proceset gjyqësore ose para autoriteteve të tjera, ose me qëllim caktimin e një përfaqësuesi për të vepruar në këtë mënyrë.

Neni 43 **Mbulimi i shpenzimeve**

1. Mbulimi i çdo shpenzimi të bërë në zbatim të kësaj Konvente nuk ka përparësi mbi mbulimin e detyrimit ushqimor.
2. Një shtet mund të kërkojë kthimin e shpenzimeve nga një palë e pasuksesshme.
3. Për qëllimet e një kërkese sipas nenit 10(1) “b” për mbulim të shpenzimeve nga një palë e pasuksesshme në përputhje me paragrafin 2, termi “kreditor” në nenin 10(1) përfshin një shtet.
4. Ky nen nuk cenon nenin 8.

Neni 44 **Kërkesat gjuhësore**

1. Një kërkesë dhe dokumente të ngjashme bëhen në gjuhën origjinale dhe shoqërohen nga një përkthim në gjuhën zyrtare të shtetit të kërkuar ose në një gjuhë tjetër që shteti i kërkuar ka përcaktuar, me anë të një deklaratë në përputhje me nenin 63 që ai do të zbatojë, nëse autoriteti kompetent i atij shteti nuk përjashton përkthimin.
2. Një shtet kontraktues që ka më shumë se një gjuhë zyrtare dhe për arsye të ligjit të brendshëm, nuk mund të pranojë për të gjithë territorin e vet dokumente në një prej këtyre gjuhëve, në përputhje me nenin 63, përcakton gjuhën në të cilën këto dokumente ose përkthimet e tyre do të hartohen për dorëzim në pjesët e përcaktuara të territorit të tij.
3. Nëse nuk bihet dakord ndryshe nga autoritetet qendrore, çdo komunikim tjetër ndërmjetkëtyre autoriteteve do të jetë në një gjuhë zyrtare të shtetit të kërkuar ose në anglisht ose frëngjisht. Megjithatë, një shtet kontraktues, me anë të bërjes së një rezerve në përputhje me nenin 62, mund të kundërshtojë përdorimin e gjuhës angleze ose gjuhës frënge.

Neni 45 **Mjetet dhe shpenzimet e përkthimit**

1. Në rastin e kërkesave sipas kapitullit III, autoritetet qendrore mund të bien dakord në një rast të veçantë ose në përgjithësi se përkthimi në një gjuhë zyrtare të shtetit të kërkuar mund të bëhet në shtetin e kërkuar nga gjuha origjinale ose nga ndonjë gjuhë tjetër e rënë dakord. Nëse nuk ka asnjë marrëveshje dhe është e pamundur për autoritetin qendror kërkues që të pajtohet me kërkesat e nenit 44(1) dhe (2), atëherë kërkesa dhe dokumentet e ngjashme mund të transmetohen me përkthim në gjuhën angleze ose frënge për përkthim të mëtejshëm në një gjuhë zyrtare të shtetit të

kërkuar.

2. Shpenzimet e përkthimit që lindin nga zbatimi i paragrafit 1 do të përballohen nga shteti kërkuar nëse nuk bihet dakord ndryshe nga autoritetet qendrore të shteteve përkatëse.

3. Pavarësisht nga neni 8, autoriteti qendror kërkuar mund të pretendojë nga një kërkuar shpenzimet e përkthimit dhe dokumenteve të ngjashme, përveç kur këto shpenzime mund të mbulojnë nga sistemi i tij i ndihmës ligjore.

Neni 46

Sistemet ligjore të paunifikuara – interpretimi

1. Në lidhje me një shtet në të cilin dy ose më shumë sisteme ligjore ose grupe rregullash ligjore në lidhje me çështje të trajtuara nga kjo Konventë, zbatohen në njësi të ndryshme territoriale:

a) çdo referencë ndaj ligjit ose procedurës të një shteti interpretohet sikur i referohet, sipas rastit, ligjit ose procedurës në fuqi në njësinë përkatëse territoriale;

b) çdo referencë ndaj një vendimi të marrë, të njohur, të njohur dhe të ekzekutuar, të ekzekutuar ose të ndryshuar në atë shtet, interpretohet sikur i referohet, sipas rastit, një vendimi të marrë, të njohur, të njohur dhe të ekzekutuar, të ekzekutuar ose të ndryshuar në njësinë përkatëse territoriale;

c) çdo referencë ndaj një autoriteti gjyqësor ose administrativ në atë shtet interpretohet sikur i referohet, sipas rastit, një autoriteti gjyqësor ose administrativ në njësinë përkatëse territoriale;

d) çdo referencë ndaj autoriteteve kompetente, organeve publike dhe organeve të tjera të atij shteti, të ndryshme nga autoritetet qendrore, interpretohet sikur i referohet, sipas rastit, organeve të autorizuar për të vepruar në njësinë përkatëse territoriale;

e) çdo referencë ndaj vendbanimit ose vendbanimit të zakonshëm në atë shtet interpretohet sikur i referohet, sipas rastit, vendbanimit ose vendbanimit të zakonshëm në njësinë përkatëse territoriale;

f) çdo referencë ndaj vendndodhjes së pasurive në atë shtet interpretohet sikur i referohet, sipas rastit, vendndodhjes së pasurive në njësinë përkatëse territoriale;

g) çdo referencë ndaj një marrëveshjeje reciprociteti në fuqi në një shtet interpretohet sikur i referohet, sipas rastit, një marrëveshjeje reciprociteti në fuqi në njësinë përkatëse territoriale;

h) çdo referencë ndaj ndihmës ligjore falas në atë shtet interpretohet sikur i referohet, sipas rastit, ndihmës ligjore falas në njësinë përkatëse territoriale;

i) çdo referencë ndaj një marrëveshjeje për mbështetjen financiare të bërë në një shtet interpretohet sikur i referohet, sipas rastit, një marrëveshjeje për mbështetjen financiare të bërë në njësinë përkatëse territoriale;

j) çdo referencë ndaj kompensimit të kostove nga një shtet interpretohet sikur i referohet, sipas rastit, kompensimit të kostove nga njësinë përkatëse territoriale.

2. Ky nen nuk zbatohet për një organizatë rajonale të integritit ekonomik.

Neni 47

Sistemet ligjore të paunifikuara – rregulla materiale

1. Një shtet kontraktues me dy ose më shumë njësi territoriale, në të cilat zbatohen sisteme të ndryshme ligjore, nuk ka detyrimin ligjor për zbatimin e kësaj Konvente për rrethana që përfshijnë vetëm këto njësi të ndryshme territoriale.

2. Një autoritet kompetent në një njësi territoriale të një shteti kontraktues me dy ose më shumë njësi territoriale në të cilat zbatohen sisteme të ndryshme ligjore, nuk ka detyrimin ligjor për njohjen ose zbatimin e një vendimi nga një shtet tjetër

kontraktues vetëm sepse vendimi është njohur ose zbatuar në një njësi tjetër territoriale të të njëjtit shtet kontraktues sipas kësaj Konvente.

3. Ky nen nuk zbatohet për një organizatë rajonale të integritit ekonomik.

Neni 48

Bashkërendimi me konventat e mëparshme të Hagës për mbështetjen financiare Në marrëdhëniet ndërmjet shteteve kontraktuese, kjo Konventë zëvendëson, në bazë të nenit 56(2), Konventën e Hagës të 2 tetorit 1973 për njohjen dhe zbatimin e vendimeve në lidhje me detyrimet ushqimore dhe konventën e Hagës të 15 prillit 1958 në lidhje me njohjen dhe zbatimin e vendimeve të detyrimeve ushqimore ndaj fëmijëve, në masën që fusha e tyre e zbatimit si ndërmjet këtyre shteteve korrespondon me fushën e zbatimit të kësaj Konvente.

Neni 49

Bashkërendimi me Konventën e Nju-Jorkut të vitit 1956

Në marrëdhëniet ndërmjet shteteve kontraktuese, kjo Konventë zëvendëson Konventën e Kombeve të Bashkuara për rivendosjen jashtë shtetit të detyrimeve ushqimore të 20 qershorit 1956, në masën që fusha e saj e zbatimit si ndërmjet këtyre shteteve korrespondon me fushën e zbatimit të kësaj Konvente.

Neni 50

Marrëdhënia me konventat e mëparshme të Hagës mbi dërgimin e dokumenteve dhe marrjen e provave

Kjo Konventë nuk cenon Konventën e Hagës të 1 marsit 1954 mbi procedurën civile, Konventën e Hagës të 15 nëntorit 1965 mbi dërgimin jashtë shtetit të dokumenteve gjyqësore dhe jashtëgjyqësore në çështjet civile ose tregtare dhe konventën e Hagës të 18 marsit 1970 mbi marrjen e provave jashtë shtetit në çështjet civile ose tregtare.

Neni 51

Bashkërendimi i instrumenteve dhe marrëveshjeve plotësuese

1. Kjo Konventë nuk cenon asnjë instrument ndërkombëtar të përfunduar para kësaj Konvente, në të cilët shtetet kontraktuese janë palë dhe që përmban dispozita për çështjet e rregulluara nga kjo Konventë.

2. Çdo shtet kontraktues mund të lidhë me një ose më shumë shtete kontraktuese marrëveshje që përmbajnë dispozita për çështjet e rregulluara nga Konventa, me synim përmirësimin e zbatimit të Konventës ndërmjet ose midis tyre, me kusht që këto marrëveshje të pajtohen me objektin dhe qëllimin e Konventës dhe të mos cenojnë, në marrëdhënien e këtyre shteteve me shtetet të tjera kontraktuese, zbatimin e dispozitave të Konventës. Shtetet që kanë lidhur këtë marrëveshje i transmetojnë një kopje depozitarit të Konventës.

3. Paragrafët 1 dhe 2 zbatohen edhe për marrëveshjet e reciprocitetit dhe ligjeve uniforme të bazuara në lidhje të veçanta ndërmjet shteteve përkatëse.

4. Kjo Konventë nuk cenon zbatimin e instrumenteve të Organizatës Rajonale të Integritit Ekonomik që është palë e kësaj Konvente, të miratuar pas lidhjes së Konventës, për çështje të rregulluara nga Konventa, me kusht që këto instrumente të mos cenojnë, në marrëdhënien e shteteve anëtare të Organizatës Rajonale të Integritit Ekonomik me shtete të tjera kontraktuese, zbatimin e dispozitave të Konventës. Për sa i përket njohjes ose zbatimit të vendimeve ndërmjet shteteve anëtare të Organizatës

Rajonale të Integrimit Ekonomik, Konventa nuk cenon rregullat e Organizatës Rajonale të Integrimit Ekonomik, të miratuara qoftë para ose pas lidhjes së Konventës.

Neni 52 **Rregulli më efektiv**

1. Kjo Konventë nuk pengon zbatimin e një marrëveshjeje, mase ose instrumenti ndërkombëtar në fuqi ndërmjet shtetit kërkues dhe shtetit të kërkuar, ose një marrëveshjeje reciprociteti në fuqi në shtetin e kërkuar, që parashikon:

- a) baza më të gjera për njohjen e vendimeve të detyrimeve ushqimore, pa cenuar nenin 22 “f” të Konventës;
- b) procedura të thjeshtuara, më të shpejta për një kërkesë për njohje ose ekzekutim dhe ekzekutimin e vendimeve të detyrimit ushqimor;
- c) ndihmë ligjore më të dobishme sesa ajo e parashikuar sipas neneve 14 deri 17; ose
- d) procedura që i lejojnë një kërkuesi nga një shtet kërkues t’i bëjë një kërkesë të drejtpërdrejtë autoritetit qendror të shtetit të kërkuar.

2. Kjo Konventë nuk pengon zbatimin e një ligji në fuqi në shtetin e kërkuar që parashikon rregulla më efektive të përmendura në paragrafin 1 “a” deri “c”. Megjithatë, për sa i përket procedurave të thjeshtuara, më të shpejta të përmendura në paragrafin 1 “b”, ato duhet të pajtohen me mbrojtjen e ofruar palëve sipas neneve 23 dhe 24, në veçanti në lidhje me të drejtat e palëve që të njoftohen për procedurat dhe t’u jepet mundësi e mjaftueshme për t’u dëgjuar dhe për efektet e çdo kundërshtimi ose apelimi.

Neni 53 **Interpretimi uniform**

Në interpretimin e kësaj Konvente, merret në konsideratë karakteri i saj ndërkombëtar dhe nevoja për të nxitur uniformitet në zbatimin e saj.

Neni 54

Rishikimi i funksionimit praktik të Konventës

1. Sekretari i Përgjithshëm i Konferencës së Hagës për të Drejtën Private Ndërkombëtare, në intervale të rregullta kohore, mbledh një komision të posaçëm, me qëllim rishikimin e funksionimit praktik të Konventës dhe nxitjen e zhvillimit të praktikave të mira sipas Konventës.
2. Për qëllimin e këtij rishikimi, shtetet kontraktuese bashkëpunojnë me Zyrën e Përhershme të Konferencës së Hagës për të Drejtën Private Ndërkombëtare në mbledhjen e informacionit, duke përfshirë statistikën dhe jurisprudencën, në lidhje me funksionimin praktik të Konventës.

Neni 55 **Ndryshimi i formularëve**

1. Formularët e bashkëlidhur kësaj Konvente mund të ndryshohen në bazë të një vendimi të një komisioni të posaçëm të mbledhur nga Sekretari i Përgjithshëm i Konferencës së Hagës për të Drejtën Private Ndërkombëtare, në të cilën ftohen të gjitha shtetet kontraktuese dhe të gjithë anëtarët. Njoftimi i propozimit për të ndryshuar formularët përfshihet në programin e mbledhjes.
2. Ndryshimet e miratuara nga shtetet kontraktuese të pranishme në Komisionin e Posaçëm do të hyjnë në fuqi për të gjitha shtetet kontraktuese ditën e parë të muajit të shtatë kalendarik pas datës së komunikimit të tyre nga depozitari për të gjitha shtetet

kontraktuese.

3. Gjatë periudhës së parashikuar në paragrafin 2, çdo shtet kontraktues, me anë të një njoftimi me shkrim drejtuar depozitarit, mund të bëjë një rezervë në përputhje me nenin 62, në lidhje me ndryshimin. Shteti që bën këtë rezervë, derisa rezerva të tërhiqet, trajtohet si shtet jo Palë në këtë Konventë në lidhje me këtë ndryshim.

Neni 56

Dispozitat e përkohshme

1. Konventa zbatohet në çdo rast kur:

a) një kërkesë sipas nenit 7 ose një kërkesë sipas kapitullit III është marrë nga autoriteti qendror i shtetit të kërkuar pasi Konventa të ketë hyrë në fuqi ndërmjet shtetit kërkues dhe shtetit të kërkuar;

b) një kërkesë e drejtpërdrejtë për njohje dhe ekzekutim është marrë nga autoriteti kompetent i shtetit të adresuar pasi Konventa të ketë hyrë në fuqi ndërmjet shtetit të origjinës dhe shtetit të adresuar.

2. Në lidhje me njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve ndërmjet shteteve kontraktuese të kësaj Konvente që janë palë edhe në ndonjë prej Konventave të Hagës për mbështetjen financiare, të përmendura në nenin 48, nëse kushtet për njohjen dhe zbatimin sipas kësaj Konvente pengojnë njohjen dhe zbatimin e një vendimi të dhënë në shtetin e origjinës para hyrjes në fuqi të kësaj Konvente për atë shtet, që do të ishte njohur dhe ekzekutuar sipas kushteve të Konventës dhe që ishte në fuqi në kohën kur është marrë vendimi, do të zbatohen kushtet e kësaj Konvente.

3. Shteti i adresuar nuk ka detyrimin ligjor sipas kësaj Konvente, për të zbatuar një vendim ose marrëveshje për mbështetjen financiare në lidhje me pagesat të cilave u ka kaluar afati para hyrjes në fuqi të Konventës ndërmjet shtetit të origjinës dhe shtetit të adresuar, me përjashtim të detyrimeve ushqimore që lindin nga marrëdhënia prind-fëmijë ndaj një personi nën moshën 21 vjeç.

Neni 57

Dhënia e informacionit në lidhje me ligjet, procedurat dhe shërbimet

1. Një shtet kontraktues, në kohën e depozitimit të instrumentit të tij të ratifikimit ose aderimit, ose kur një deklaratë është paraqitur në përputhje me nenin 61 të Konventës, i paraqet Zyrës së Përhershme të Konferencës së Hagës për të Drejtën Private Ndërkombëtare:

a) një përshkrim të ligjeve dhe procedurave të tij në lidhje me detyrimet ushqimore;

b) një përshkrim të masave që do të marrë për të përmbushur detyrimet sipas nenit 6;

c) një përshkrim të mënyrës sesi do t'u sigurojë kërkuesve akses efektiv për t'iu drejtuar procedurave të kërkuara sipas nenit 14;

d) një përshkrim të rregullave dhe procedurave të tij të zbatimit, duke përfshirë çdo kufizim ndaj zbatimit, në veçanti rregullat e mbrojtjes së debitorit dhe periudhat e parashkrimit;

e) çdo specifikim të përmendur në nenin 25(1) "b" dhe (3).

2. Në përmbushjen e detyrimeve të tyre sipas paragrafit 1, shtetet kontraktuese mund të përdorin një formular të profilit të vendit të rekomanduar dhe publikuar nga Konferenca e Hagës për të Drejtën Private Ndërkombëtare.

3. Informacioni ruhet i përditësuar nga shtetet kontraktuese.

KAPITULLI IX

DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 58

Nënshkrimi, ratifikimi dhe aderimi

1. Konventa është e hapur për nënshkrim nga shtetet që kanë qenë anëtare të Konferencës së Hagës për të Drejtën Private Ndërkombëtare në kohën e sesionit të saj të njëzetënjëtë dhe nga shtetet e tjera që kanë marrë pjesë në atë sesion.
2. Ajo ratifikohet, pranohet ose miratohet dhe instrumentet e ratifikimit, pranimi ose miratimit depozitohen pranë Ministrisë së Punëve të Jashtme të Mbretërisë së Holandës, depozitari i Konventës.
3. Çdo organizatë tjetër shtetërore ose rajonale e integritit ekonomik mund të aderojë në Konventë pasi të ketë hyrë në fuqi në përputhje me nenin 60(1).
4. Instrumenti i aderimit depozitohet pranë depozitarit.
5. Ky aderim ka fuqi vetëm në lidhje me marrëdhëniet ndërmjet shtetit aderues dhe atyre shteteve kontraktuese që nuk kanë paraqitur kundërshtim për aderimin e tij brenda një periudhe 12- mujore pas datës së njoftimit të përmendur në nenin 65. Ky kundërshtim mund të paraqitet edhe nga shtetet në kohën kur ato ratifikojnë, pranojnë ose miratojnë Konventën pas një aderimi. Çdo kundërshtim i tillë i njoftohet depozitarit.

Neni 59

Organizatrat rajonale të integritit ekonomik

1. Një organizatë rajonale e integritit ekonomik, që përbëhet vetëm nga shtetet sovraane dhe ka kompetencë mbi disa ose të gjitha çështjet e rregulluara nga kjo Konventë, gjithashtu mund të nënshkruajë, pranojë, miratojë ose aderojë në këtë Konventë. Në këtë rast, Organizata Rajonale e Integritit Ekonomik do të ketë të drejtat dhe detyrimet e një shteti kontraktues në masën që Organizata ka kompetencë mbi çështjet e rregulluara nga Konventa.
2. Në kohën e nënshkrimit, pranimi, miratimit ose aderimit, Organizata Rajonale e Integritit Ekonomik njofton me shkrim depozitarin për çështjet e rregulluara nga kjo Konventë, në lidhje me të cilat kompetenca është transferuar në këtë Organizatë nga shtetet e saj anëtare. Organizata njofton menjëherë depozitarin me shkrim për çdo ndryshim në kompetencën e saj të përcaktuar në njoftimin më të fundit të dhënë sipas këtij paragrafi.
3. Në kohën e nënshkrimit, pranimi, miratimit ose aderimit, një organizatë rajonale e integritit ekonomik mund të deklarojë, në përputhje me nenin 63, se ushtron kompetencë mbi të gjitha çështjet e rregulluara nga kjo Konventë dhe se shtetet anëtare që kanë transferuar kompetencën tek Organizata Rajonale e Integritit Ekonomik në lidhje me çështjen në fjalë, kanë detyrim ligjor sipas kësaj Konvente për shkak të nënshkrimit, pranimi, miratimit ose aderimit të Organizatës.
4. Për qëllimet e hyrjes në fuqi të kësaj Konvente, çdo instrument i depozituar nga një organizatë rajonale e integritit ekonomik nuk do të merret në konsideratë nëse organizata rajonale e integritit ekonomik nuk bën një deklaratë në përputhje me paragrafin 3.
5. Çdo referencë ndaj një “shteti kontraktues” ose “shteti” në këtë Konventë zbatohet njëllë për një organizatë rajonale të integritit ekonomik që është palë e saj, sipas rastit. Në rast se një deklaratë është bërë nga një organizatë rajonale e integritit ekonomik në përputhje me paragrafin 3, çdo referencë ndaj një “shteti kontraktues” ose “shteti” në këtë Konventë zbatohet njëllë, sipas rastit, për shtetet anëtare përkatëse të Organizatës.

Neni 60

Hyrja në fuqi

1. Konventa hyn në fuqi ditën e parë të muajit pas tre muajve nga depozitimi i instrumentit të dytë të ratifikimit, pranimit ose miratimit të përmendur në nenin 58.
2. Më pas, Konventa hyn në fuqi:
 - a) për çdo organizatë shtetërore ose rajonale të integritit ekonomik të përmendur në nenin 59(1) që më pas e ratifikon, pranon ose miraton atë, ditën e parë të muajit pas tre muajve nga depozitimi i instrumentit të saj të ratifikimit, pranimit ose miratimit;
 - b) për çdo organizatë shtetërore ose rajonale të integritit ekonomik të përmendur në nenin 58 (3), ditën pas përfundimit të periudhës gjatë të cilës mund të paraqiten kundërshtime në përputhje me nenin 58(5);
 - c) për një njësi territoriale në të cilën është shtrirë Konventa në përputhje me nenin 51, ditën e parë të muajit, pas tre muajve nga njoftimi i përmendur në atë nen.

Neni 61

Deklaratat në lidhje me sistemet ligjore të paunifikuara

1. Nëse një shtet ka dy ose më shumë njësi territoriale në të cilat zbatohen sisteme të ndryshme ligjore në lidhje me çështjet e trajtuara në Konventë, në kohën e nënshkrimit, ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit, ai mund të deklarojë, në përputhje me nenin 63, se kjo Konventë do të shtrihet në të gjitha njësitë e tij territoriale ose vetëm në një ose më shumë prej tyre dhe mund të ndryshojë këtë deklaratë duke paraqitur në çdo kohë një deklaratë tjetër.
2. Çdo deklaratë e tillë i njoftohet depozitarit dhe përcakton shprehimisht njësitë territoriale në të cilat zbatohet Konventa.
3. Nëse një shtet nuk bën asnjë deklaratë sipas këtij neni, Konventa do të shtrihet në të gjitha njësitë territoriale të atij shteti.
4. Ky nen nuk zbatohet për një organizatë rajonale të integritit ekonomik.

Neni 62

Rezervat

1. Çdo shtet kontraktues, jo më vonë se koha e ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit ose në kohën e bërjes së një deklaratë në lidhje me nenin 61, mund të bëjë një ose më shumë rezerva të parashikuara në nenet 2(2), 20(2), 30(8), 44(3) dhe 55(3). Nuk lejohet asnjë rezervë tjetër.
2. Çdo shtet mund të tërheqë në çdo kohë një rezervë që ka bërë. Tërheqja i njoftohet depozitarit.
3. Rezerva pushon së qeni në fuqi ditën e parë të muajit të tretë kalendarik pas njoftimit të përmendur në paragrafin 2.
4. Rezervat sipas këtij neni nuk kanë ndikim të ndërsjellë, me përjashtim të rezervës së parashikuar në nenin 2 (2).

Neni 63

Deklaratat

1. Deklaratat e përmendura në nenet 2(3), 11(1) “g”, 16(1), 24(1), 30(7), 44(1) dhe (2), 59(3) dhe 61(1), mund të bëhen me nënshkrimin, ratifikimin, pranimin, miratimin ose aderimin, ose në një kohë të mëpasshme, dhe mund të ndryshohen ose tërhiqen në

çdo kohë.

2. Deklaratat, ndryshimet dhe tërheqjet i njoftohen depozitarit.

3. Një deklaratë e bërë në kohën e nënshkrimit, ratifikimit, pranimit ose aderimit hyn në fuqi njëkohësisht me hyrjen në fuqi të kësaj Konvente për shtetin përkatës.

4. Një deklaratë e bërë në një kohë të mëpasshme dhe çdo ndryshim ose tërheqje e një deklaratë hyn në fuqi ditën e parë të muajit pas mbarimit të tre muajve nga data në të cilën njoftimi është marrë nga depozitari.

Neni 64 Denoncimi

1. Një shtet kontraktues i Konventës mund ta denoncojë atë me anë të një njoftimi me shkrim të drejtuar depozitarit. Denoncimi mund të kufizohet në disa njësi territoriale të një shteti me shumë njësi në të cilin zbatohet Konventa.

2. Denoncimi hyn në fuqi ditën e parë të muajit pas mbarimit të 12 muajve pas datës në të cilën njoftimi është marrë nga depozitari. Kur njoftimi përcakton një periudhë më të gjatë për hyrjen në fuqi të denoncimit, ky i fundit hyn në fuqi pas mbarimit të kësaj periudhe më të gjatë pas datës në të cilën njoftimi është marrë nga depozitari.

Neni 65 Njoftimi

Depozitari njofton anëtarët e Konferencës së Hagës për të Drejtën Private Ndërkombëtare dhe organizata të tjera shtetërore dhe rajonale të integritit ekonomik që kanë nënshkruar, ratifikuar, pranuar, miratuar ose aderuar në përputhje me nenet 58 dhe 59 sa më poshtë:

- a) nënshkrimet, ratifikimet, pranimet dhe miratimet e përmendura në nenet 58 dhe 59;
- b) aderimet dhe kundërshtimet e paraqitura ndaj aderimeve të përmendura në nenet 58(3) dhe (5) dhe 59;
- c) data në të cilën Konventa hyn në fuqi në përputhje me nenin 60;
- d) deklaratat e përmendura në nenet 2(3), 11(1) g), 16(1), 24(1), 30(7), 44(1) dhe (2), 59(3) dhe 61(1);
- e) marrëveshjet e përmendura në nenin 51(2);
- f) rezervat e përmendura në nenet 2(2), 20(2), 30(8), 44(3) dhe 55(3), dhe tërheqjet e përmendura në nenin 62(2);
- g) denoncimet e përmendura në nenin 64.

Në dëshmi të kësaj, nënshkruesit, duke qenë të autorizuar sipas rregullave, kanë nënshkruar këtë Konventë.

Bërë në Hagë më 23 nëntor 2007, në gjuhën angleze dhe frënge, ku të dyja tekstet janë njëloj autentikë, në një kopje të vetme e cila depozitohet në arkivat e Qeverisë së Mbretërisë së Holandës, dhe një kopje e vërtetuar e së cilës i dërgohet nëpërmjet rrugëve diplomatike secilit prej anëtarëve të Konferencës së Hagës për të Drejtën Private Ndërkombëtare në datën e sesionit të saj të njëzetënjëtë dhe secilit prej shteteve të tjera që kanë marrë pjesë në këtë sesion.

SHTOJCA 1

Formulari i transmetimit sipas Nenit 12(2)

NJOFTIM PËR MBROJTJEN E FSHEHTËSISË DHE TË DHËNAVE PERSONALE

Të dhënat personale të mbledhura ose të transmetuara sipas Konventës përdoren vetëm për qëllimet për të cilat janë mbledhur ose transmetuar. Çdo autoritet që përpunon këto të dhëna garanton fshehtësinë e tyre në përputhje me ligjin e Shtetit të tij.

Një autoritet nuk zbulon ose konfirmon informacionin e mbledhur ose të transmetuar në zbatim të kësaj Konvente, nëse përcakton se kjo mund të rrezikojë shëndetin, sigurinë ose lirinë e një personi në përputhje me Nenin 40.

Një përcaktim i moszbulimit të informacionit bëhet nga një Autoritet Qendror në përputhje me Nenin 40.

1. Autoriteti Qendror kërkues	2. Personi i kontaktit në Shtetin kërkues
a. Adresa	a. Adresa (nëse është e ndryshme)
b. Numri i telefonit	b. Numri i telefonit (nëse është i ndryshëm)
c. Numri i faksit	c. Numri i faksit (nëse është i ndryshëm)
d. E-mail	d. E-mail (nëse është i ndryshëm)
e. Numri i referencës	e. Gjuha (ët)

3. Autoriteti Qendror i Kërkuar

Adresa

.....

4. Të dhëna për kërkuesin

a. Mbiemri
(at):

b. Emri (at):
.....

c. Data e lindjes:(dd/mm/vvvv)

ose

a. Emri i organit

publik:

.....

5. Të dhëna të personit (ve) për të cilët kërkohet detyrimi ushqimor ose është i pagueshëm

a. Personi është i njëjtë si kërkuesi i përmendur në pikën 4

b. i. Mbiemri

(at):

Emri (at):

Data e lindjes:..... (dd/mm/vvvv)

ii. Mbiemri

(at):

Emri (at):

Data e lindjes:..... (dd/mm/vvvv)

iii. Mbiemri (at):

.....

Emri (at):

Data e lindjes:..... (dd/mm/vvvv)

6. Të dhëna për debitorin

a. Personi është i njëjtë si kërkuesi i përmendur në pikën 4

b. Mbiemri (at):

c. Emri (at):

d. Data e lindjes: (dd/mm/vvvv)

7. Ky formular transmetimi ka lidhje me dhe shoqërohet nga një kërkesë sipas:

Nenit 10(1) a)

Nenit 10(1) b)

Nenit 10(1) c)

Nenit 10(1) d)

Nenit 10(1) e)

Nenit 10(1) f)

Nenit 10(2) a)

Nenit 10(2) b)

Nenit 10(2) c)

8. Dokumentet e mëposhtme i bashkëlidhen kërkesës:

a. Për qëllimin e një kërkesë sipas Nenit 10(1) a) dhe:

Në përputhje me Nenin 25:

- Teksti i plotë i vendimit (Neni 25(1) a))
- Përmbledhja ose pjesa e vendimit të përpiluar nga autoriteti kompetent i Shtetit të origjinës (Neni 25(3) b)) (nëse është e zbatueshme)
- Dokumenti që deklaron se vendimi është i zbatueshëm në Shtetin e origjinës dhe, në rast të një vendimi nga një autoritet administrativ, një dokument që deklaron se kërkesat e Nenit 19(3) janë përmbushur nëse ai Shtet nuk ka përcaktuar në përputhje me Nenin 57 se vendimet e autoriteteve të tij administrative përmbushin këto kërkesa në çdo rast (Neni 25(1) b)) ose nëse Neni 25(3) c) është i zbatueshëm.
- Nëse i padituri nuk është paraqitur dhe nuk është përfaqësuar në procedimet në Shtetin e origjinës, një dokument ose dokumente që provojnë, sipas rastit, ose se i padituri është njoftuar për procedimet dhe ka patur një mundësi për t'u dëgjuar, ose se i padituri është njoftuar për vendimin dhe ka patur mundësinë për ta kundërshtuar ose apeluar atë në bazë të fakteve dhe ligjit (Neni 25(1) c))
- Nëse është e nevojshme, një dokument që tregon shumën e çdo pagese të prapambetur dhe datën në të cilën kjo shumë është llogaritur (Neni 25(1) d))
- Nëse është e nevojshme, një dokument që ofron informacionin e nevojshëm për bërjen e llogaritjeve të duhura në rast të një vendimi që parashikon rregullim automatik me indeksim (Neni 25(1) e))
- Nëse është e nevojshme, dokumentacion që tregon masën në të cilën kërkuesi ka marrë ndihmë ligjore falas në Shtetin e origjinës (Neni 25(1) f))

Në përputhje me Nenin 30(3):

- Tekste të plota të marrëveshjes pwr detyrimet ushqimore (Neni 30(3) a))
- Një dokument që deklaron se marrëveshja e veçantë pwr detyrimet ushqimore është e ekzekutueshme si një vendim në Shtetin e origjinës (Neni 30(3) b))
- Çdo dokument tjetër që shoqëron kërkesën (*për shembull*, nëse kërkohet, një dokument për qëllim të Nenit 36(4)):

.....
.....

b. Për qëllim të një kërkesë sipas Nenit 10(1) b), c), d), e), f) dhe (2) a), b) ose c), numri i mëposhtëm i dokumenteve mbështetëse (duke përjashtuar formularin e transmetimit dhe vetë kërkesën) në përputhje me Nenin 11(3):

- Neni 10(1) b)
- Neni 10(1) c)
- Neni 10(1) d)
- Neni 10(1) e)
- Neni 10(1) f)
- Neni 10(2) a)
- Neni 10(2) b)
- Neni 10(2) c)

Emri:(në germa kapitale)

Data:

Përfaqësuesi i autorizuar i Autoritetit Qendror
(dd/mm/vvvv)

SHTOJCA 2

Formulari i pranimit sipas Nenit 12(3)

NJOFTIM PËR MBROJTJEN E FSHEHTËSISË DHE TË DHËNAVE PERSONALE

Të dhënat personale të mbledhura ose të transmetuara sipas Konventës përdoren vetëm për qëllimet për të cilat janë mbledhur ose transmetuar. Çdo autoritet që përpunon këto të dhëna garanton fshehtësinë e tyre në përputhje me ligjin e Shtetit të tij.

Një autoritet nuk zbulon ose konfirmon informacionin e mbledhur ose të transmetuar në zbatim të kësaj Konvente, nëse përcakton se kjo mund të rrezikojë shëndetin, sigurinë ose lirinë e një personi në përputhje me Nenin 40.

Një përcaktim i moszbulimit të informacionit bëhet nga një Autoritet Qendror në përputhje me Nenin 40.

1. Autoriteti Qendror i kërkuar	2. Personi i kontaktit në Shtetin e kërkuar
a. Adresa	a. Adresa (nëse është e ndryshme)
b. Numri i telefonit	b. Numri i telefonit (nëse është i ndryshëm)
c. Numri i faksit	c. Numri i faksit (nëse është i ndryshëm)
d. E-mail	d. E-mail (nëse është i ndryshëm)
e. Numri i referencës	e. Gjuha (ët)

3. Autoriteti Qendror Kërkues

Personi i kontaktit

Adresa

.....

4. Autoriteti Qendror i Kërkuar konfirmon marrjen më (dd/mm/vvvv) e formularit të transmetimit nga Autoriteti Qendror kërkues (numri i referencës.....; i datës..... (dd/mm/vvvv)) në lidhje me kërkesën e mëposhtme sipas:

- Nenit 10(1) a)
- Nenit 10(1) b)
- Nenit 10(1) c)

- Nenit 10(1) *d*
- Nenit 10(1) *e*
- Nenit 10(1) *f*
- Nenit 10(2) *a*
- Nenit 10(2) *b*
- Nenit 10(2) *c*

Mbiemri (at) i/e kërkuesit:

.....

Mbiemri (at) i/e personit (ve) për të cilët mbështetja financiare kërkohet ose është e pagueshme:

.....

.....

Mbiemri (at) i/e debitorit:

.....

5. Hapat fillestarë të marrë nga Autoriteti Qendror i kërkuar:

- Dosja është e plotë dhe nën shqyrtim
- Shihni bashkëlidhur statusin e raportit të kërkesës
- Statusi i raportit të kërkesës në vijim
- Ju lutem jepni informacionin dhe/ose dokumentacionin e mëposhtëm shtesë:

.....

.....

Autoriteti Qendror i kërkuar refuzon të trajtojë këtë kërkesë pasi është e qartë se kërkesat e Konventës nuk janë plotësuar (Neni 12(8)). Arsyet:

- përcaktohen në një dokument bashkëlidhur
- përcaktohen në një dokument vijues

Autoriteti Qendror i kërkuar kërkon që Autoriteti Qendror kërkues ta informojë atë për çdo ndryshim në statusin e kërkesës.

Emri: (në germa kapitale)

Data:

Përfaqësuesi i autorizuar i Autoritetit Qendror
(dd/mm/vvvv)